

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	E Drejta Biznesore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Armand Krasniqi MSc.Diamanta Sojeva
Detajet kontaktuese:	armand.krasniqi@uni-pr.edu diamanta.sojeva@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda “E Drejta Biznesore” ofron njohuri themelore për rregullimin juridik të veprimtarisë biznesore, duke trajtuar çështje të theksuara më poshtë. <u>Edhe pse titullohet “e drejtë”</u>, përmbajtja e saj ka karakter tërësisht ekonomik, pasi synon të shpjegojë mekanizmat juridikë që mundësojnë funksionimin e tregut dhe marrëdhënieve biznesore në kontekstin institucional dhe normativ.</p> <p>Si e tillë kjo lëndë është pjesë themelore e kurrikulës së Fakultetit Ekonomik dhe ka për qëllim të ofrojë një kuptim të qartë dhe të sistematizuar të bazave juridike që rregullojnë veprimtarinë ekonomike dhe tregtare. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët njihen me strukturën themelore të rendit juridik, natyrën e normave juridike dhe raportin e tyre me ekonominë moderne. Lënda mbulon një spektër të gjerë temash, duke përfshirë të drejtën e detyrimeve dhe kontratat, format juridike të subjekteve biznesore, funksionimin e shoqërive tregtare, sistemin bankar, të drejtën e pronësisë industriale dhe të drejtën e letrave me vlerë. Rëndësi e veçantë i kushtohet ndërthurjes së sistemit juridik me realitetin ekonomik, në mënyrë që studentët të aftësohen për të kuptuar dhe interpretuar rregullimin juridik të biznesit si pjesë e pandashme e funksionimit të tregut dhe të shtetit të së drejtës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi parësor i lëndës është të zhvillojë tek studentët një bazë të fuqishme të të kuptuarit juridik në sferën ekonomike, duke nxitur mendimin kritik dhe aftësinë për të aplikuar parimet juridike në situata konkrete të biznesit. Lënda synon të: Pajisë studentët me njohuri të përgjithshme për strukturën e sistemit juridik dhe rolin e tij në rregullimin e veprimtarisë ekonomike; Edukojë kuptimin e funksionit të shtetit të së drejtës, organeve</p>

	publike dhe sistemit normativ në ndërtimin e sigurisë ligjore për biznesin; Thellojë njohuritë për subjektet e së drejtës dhe format e organizimit të ndërmarrjeve ekonomike; Aftësojë studentët për të analizuar burimet e së drejtës, kontratat biznesore dhe format e detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhëniet ekonomike; Zgjerojë të kuptuarit për pronën industriale dhe të drejtën e autorit si mekanizma juridikë për mbrojtjen e inovacionit dhe të konkurrencës në treg.
--	--

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit me sukses të lëndës, studenti pritët të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizojë funksionin e së drejtës dhe të shtetit në ndërtimin e një rendi ekonomik të qëndrueshëm dhe të drejtë; • Dallojë llojet e normave juridike dhe ndikimin e tyre mbi sjelljen e subjekteve ekonomike në treg; • Njohë burimet formale dhe materiale të së drejtës biznesore, si dhe të identifikojë rëndësinë e tyre në zbatimin praktik të rregullave ekonomike; • Kuptojë dhe interpretojë llojet kryesore të kontratave biznesore dhe rregullimin e detyrimeve në marrëdhëniet afariste; • Njohë dhe vlerësojë format juridike të organizimit të ndërmarrjeve, përfshirë mënyrat e regjistrimit dhe shuarjes së tyre; • Vlerësojë rëndësinë e të drejtës industriale dhe të letrave me vlerë në mjedisin bashkëkohor të tregut dhe të jetë i aftë të aplikojë dijen në raste konkrete.
---	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume	3	3	6
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15

Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5																											
Projektet, prezantimet ,etj	1	4	4																											
Totali			100																											
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Procesi i mësimdhënies organizohet përmes kombinimit të ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike. Ligjëratat synojnë të prezantojnë konceptet themelore dhe kornizat juridike që rregullojnë aktivitetin ekonomik, ndërsa ushtrimet përqendrohen në analiza të rasteve, punime kërkimore dhe diskutime në grup mbi zbatimin praktik të të drejtës në kontekstin e biznesit. Përdorimi i shembujve konkretë nga praktika vendore dhe ndërkombëtare shërben për të zhvilluar aftësitë analitike dhe praktike të studentëve. Studentët inkurajohen të angazhohen në mënyrë aktive përmes prezantimeve dhe punës individuale apo në grup, me qëllim nxitjen e të menduarit kritik dhe të ndërveprimit konstruktiv gjatë procesit mësimor.</p>																													
Metoda e vlerësimit:																														
Vlerësimi ne %	<table> <tr> <td>91 – 100% = nota 10</td> <td>Vijimi i ligjëratave</td> <td>= 0%</td> </tr> <tr> <td>81 – 90 % = nota 9</td> <td>Punimi kërkimor</td> <td>= 0%</td> </tr> <tr> <td>71 – 80% = nota 8</td> <td>Punimi seminarik</td> <td>= 10 %</td> </tr> <tr> <td>61 – 70% = nota 7</td> <td>Testi i parë</td> <td>= 25%</td> </tr> <tr> <td>51 – 60% = nota 6</td> <td>Testi i dytë</td> <td>= 25 %</td> </tr> <tr> <td>0 – 50% = nota 5</td> <td>Testi i tretë</td> <td>= 35%</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Pjesëmarrja ne ushtrime</td> <td>= 0</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Aktiviteti në ushtrime</td> <td>= 5%</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Puna grupore dhe rasti i studimit</td> <td>= 0</td> </tr> </table>			91 – 100% = nota 10	Vijimi i ligjëratave	= 0%	81 – 90 % = nota 9	Punimi kërkimor	= 0%	71 – 80% = nota 8	Punimi seminarik	= 10 %	61 – 70% = nota 7	Testi i parë	= 25%	51 – 60% = nota 6	Testi i dytë	= 25 %	0 – 50% = nota 5	Testi i tretë	= 35%		Pjesëmarrja ne ushtrime	= 0		Aktiviteti në ushtrime	= 5%		Puna grupore dhe rasti i studimit	= 0
91 – 100% = nota 10	Vijimi i ligjëratave	= 0%																												
81 – 90 % = nota 9	Punimi kërkimor	= 0%																												
71 – 80% = nota 8	Punimi seminarik	= 10 %																												
61 – 70% = nota 7	Testi i parë	= 25%																												
51 – 60% = nota 6	Testi i dytë	= 25 %																												
0 – 50% = nota 5	Testi i tretë	= 35%																												
	Pjesëmarrja ne ushtrime	= 0																												
	Aktiviteti në ushtrime	= 5%																												
	Puna grupore dhe rasti i studimit	= 0																												
Literatura																														
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dr. Armand Krasniqi "E drejta biznesore" Edicioni i tretë – CSARA 2019. 2. Dr. Armand Krasniqi "E drejta biznesore" Kolegji Dukagjini 2014 3. Dr. Armand Krasniqi "E drejta tregtare" CSARA 2021 																													

Literatura shtesë:	<p>Sipas nevojës, në formë elektronike ose në fotokopje, gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, do të shpërndahen edhe materiale të ndryshme në lidhje me problemet aktuale zhvillimore.</p> <p>Rekomandohet literaturë:</p> <ul style="list-style-type: none"> □ Business Law and the Legal Environment – Open Textbook Library https://open.umn.edu/opentextbooks/textbooks/business-law-and-the-legal-environment □ Business Law I Essentials – OpenStax https://openstax.org/details/books/business-law-i-essentials □ Fundamentals of Business Law – Open Textbook Library https://open.umn.edu/opentextbooks/textbooks/fundamentals-of-business-law-randall □ Advanced Business Law and the Legal Environment – Open Access https://libguides.tru.ca/lawopenaccess/businesslaw □ Legal Information Institute – Cornell Law School https://www.law.cornell.edu □ FindLaw – Business Law Center https://www.findlaw.com/business.html □ Justia – Business Law Resources https://www.justia.com/business □ OpenTuition – Corporate and Business Law (LW) https://opentuition.com/acca/lw □ Business Law – OER Commons https://oercommons.org/browse?f.keyword=business-law □ Business Law Resources – American Bar Association https://www.americanbar.org/groups/business_law/resources
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i programit – Shteti, nocioni dhe karakteristikat shtetit dhe të drejtës,
Java e dytë:	Marrëdhëniet juridike, Faktet Juridike, Rendi juridik dhe sistemi juridik Normat zakonore, morale dhe juridike; Llojet e normave juridike;
Java e tretë:	Hyrje në të drejtën Biznesore , Objekti, Kuptimi, Metodat, Parimet e rregullimit të së drejtës biznesore
Java katër	Burimet e të drejtës biznesore, Burimet juridike materiale dhe formale; Kushtetuta, Ligji, Marrëveshjet ndërkombëtare (konventat), Aktet nënligjore, Aktet e përgjithshme të ndërmarrjeve dhe shoqërive, Zakonet, Uzansat , Kushtet e përgjithshme të biznesit, Precedentët

Java e pestë:	Subjekte e të drejtës biznesore Personat fizikë, Personat Juridikë Objekti i marrëdhënieve biznesore; Punët juridike; Elementet e punës juridike; Përfaqësim
Java e gjashtë:	Testi i parë (1) E drejta e detyrimeve; Kontratat, parimet e së drejtës kontraktore dhe kushtet për lidhjen e kontratës
Java e shtatë:	Lidhja e kontratës dhe efektet juridike; Përforcimi i kontratës
Java e tetë:	Kuptimi dhe ndarje e kontratave; Kontratat elektronike
Java e nëntë:	Shkaktimi i dëmit; Efektet e detyrimeve; Llojet e ndryshme të detyrimeve; Shuarja e detyrimeve
Java e dhjetë:	Testi i dytë (2) E Drejta statusore: Subjektet biznesore dhe shoqëritë tregtare; Format juridike biznesore; Ndërmarrja Individuale Shoqëria ortakëria e përgjithshme; Shoqëria ortakërisë së kufizuar
Java e njëmbëdhjetë:	Shoqëria më përgjegjësi të kufizuar; Shoqëria Aksionare; Ndërmarrja publike;
Java e dymbëdhjetë:	Ndërmarrja shoqërore; Kooperativat, Ndërlidhja dhe riorganizimi i shoqërive biznesore dhe Shuarja e shoqërove biznesore, Likuidimi, falimentimi dhe riorganizimi
Java e trembëdhjetë:	Prona industriale, E drejta e autorit e dhe të drejtat tjera të përafërta
Java e katërbëdhjetë:	Njohuritë themelore për rregullat e letrave me vlerë; Çeku, kuptimi dhe karakteristikat Kambali, kuptimi dhe karakteristikat; Kartelat kreditore, llojet dhe karakteristikat; Letrat legjitimuese dhe shenjat
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i tretë (3)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- ☞ Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin, orarin dhe rregullat e caktuara nga fakulteti
- ☞ Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore
- ☞ Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimmshënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.